



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Delta Security shpk” të datës 15.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e Sigurimit Fizik - për shtëpinë e të moshuarëve dhe pa përkujdesje Familjare” me nr. të prokurimit 616-26-2900-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Delta Security shpk” të datës 15.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e Sigurimit Fizik - për shtëpinë e të moshuarëve dhe pa përkujdesje Familjare” me nr. të prokurimit 616-26-2900-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Delta Security shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 15.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e Sigurimit Fizik - për shtëpinë e të moshuarëve dhe pa përkujdesje Familjare” me nr. të prokurimit 616-26-2900-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

"Fakti 1 (Kalkulimi i vlerës së parashikuar): Autoriteti Kontraktues (AK) ka parashikuar vlerën totale prej 20,203.20 € për një sasi prej 6,624 orësh shërbimi. Siç shihet edhe nga të dhënat e tabelës për vlerën e parashikuar (të reflektuar te OE "SKYFTERAT"), kjo rezulton në një çmim njësi prej 3.05 € për orë (me TVSH). Kur hiqet TVSH-ja, çmimi neto prej 2.58 €/orë gjeneron një pagë prej vetëm 452.33 €, duke dështuar të mbulojë pagën minimale ligjore prej 500.00 € (mungesë prej -47.67 €). Ky fakt treshon se edhe vetë vlera e parashikuar nga AK ka qenë e kalkuluar gabim dhe në kundërshtim me ligjin, duke mos reflektuar ndryshimet e reja ligjore.

□ **Fakti 2 (Pamundësia ligjore e çmimit të parashikuar):** Çmimi neto prej 2.58 € për orë (i kalkuluar nga vlera e parashikuar) është faktikisht dhe ligjërisht i pamjaftueshëm. Ai jo vetëm që nuk mbulon koston e pastër të krahut të punës sipas Vendimit të ri të Qeverisë për Pagën Minimale në Kosovë (500.00 €), por lë krejtësisht jashtë llogaritjes kontributet e detyrueshme pensionale (5%), taksat mbi pagë, si dhe shtesat ligjore për ndërrimet e natës (30%) dhe festat zyrtare dhe vikendi (50%) për shërbim 24/7.

□ **Fakti 3 (Përgjegjshmëria e plotë dhe saktësia e ofertës sonë):** Në Letrën Standarde të AK-së (Formulari B58), Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar zyrtarisht se oferta jonë ("DELTA SECURITY") është vlerësuar si e përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Ne jemi eliminuar vetëm për shkak të çmimit total prej 24,045.12 € (3.63 € për orë me TVSH). Megjithatë, siç vërtetohet nga tabela, ky është i vetmi çmim real dhe ligjor që rezulton në një pagë prej 538.35 €, duke kaluar pragun e pagës minimale prej 500 € dhe duke krijuar hapësirë për obligimet tjera ligjore (38.35 €). Për më tepër, oferta jonë nuk e kalon devijimin e lejuar prej 30% nga vlera e parashikuar ($24,045.12 / 20,203.20 = 1.19$, që nënkupton një devijim prej vetëm 19%). Ne kemi respektuar marzhin e devijimit pikërisht për t'u përshtatur me ligjin.

□ **Fakti 4 (Mos-përdorimi i Klauzolës së Variacionit):** Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit thuhet shprehimisht: "Sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është (- 30%)". AK-ja ka pasur hapësirë të plotë ligjore që përmes këtij variacioni ta përshtasë buxhetin ose sasinë, në mënyrë që të mos eliminonte të vetmin operator plotësisht të përgjegjshëm dhe ligjor në këtë procedurë.

□ **Fakti 5 (Shpërblimi i operatorit të papërgjegjshëm - KSF MAJOR SHA):** Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë OE "KSF MAJOR SHA" me çmim total prej 16,493.76 € (2.49 € për orë me TVSH). Kur zbritet TVSH-ja, çmimi neto për orë mbetet vetëm 2.11 €. I shumëzuar me orarin e rregullt prej 175 orësh në muaj, ky çmim gjeneron një pagë prej vetëm 369.28 €. Ky është argumenti i pakontestueshëm matematik se ky OE është plot -130.72 € LARG Vendimit të Qeverisë Nr. 10/273 për pagën minimale prej 500 €. Ky çmim nuk mbulon as pagën bazë, e lere më detyrimet tjera (pajisjet, uniformat, kontributet pensionale, shtesat prej 50% për natën, etj.).

□ **Fakti 6 (Papërgjegjshmëria e operatorit MEB LLC):** E njëjta situatë e jashtëligjshme vlen edhe për OE "MEB LLC", i cili ka ofruar vlerën 17,089.92 €

(2.58 € për orë me TVSH). Çmimi neto pa TVSH prej 2.19 € për orë gjeneron një pagë prej vetëm 382.63 €, duke qenë në mungesë ligjore prej -117.37 € nga pragu i pagës minimale.

Përfundim i asaj që shihet qartë: Të tre operatorët ekonomikë që janë më lirë se ne, nuk e plotësojnë ligjin primar të punës në Kosovë, duke dëshmuar se çmimet e tyre janë anormalisht të ulëta”.

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština - Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT
KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS



LETËR STANDARDE PËR TENDERUESIN E ELIMINUAR

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Shërbimet e Sigurimit Fizik - për shtëpinë e të moshuarëve dhe pa përkujdesje Familjare.

Numri i aktivitetit të prokurimit

Nr i prokurimit	616-26-2900-2-2-1
Nr i brendshëm	616-26-53-2-2-1

Të nderuar/a
OPERATORI EKONOMIK: Delta Security SH.P.K. Enver Maloku nr.108, PRISHTINË
810325614

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP". Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar, pasi është vlerësuar si e papërgjegjshme për arsyet në vijim:

Komisioni i Vlerësimit, pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertës tuaj nga Komisioni i Vlerësimit, është konstatuar se: Oferta juaj është vlerësuar si e përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Megjithatë, oferta juaj është vlerësuar si e pasuksesshme, për shkak se çmimi i ofertuar tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës, e cila është përcaktuar në Deklaratën e Disponueshmërisë së Fondeve në shumën prej 20,203.20 Euro.
Ndërsa oferta juaj financiare është në vlerë prej 24,045.12 Euro.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Adresa: Rr. UÇK 2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 230 900, <http://www.pristina.rks-gov.net/>

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.06.2026



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.